

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me kohë të plotë në pozicionin “Kryesekretare Mësimore”, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike duhet të plotësoj kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar Ciklin e Dytë “Master i Shkencave” sipas sistemit (3+2) ose të ketë Diplomë të Integruar sipas sistemit pesëvjeçar (5-vjeçar).
2. Kandidati duhet të njohë Kornizën Shqiptare të Kualifikimit, në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.
3. Kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
4. Kandidati duhet të njohë programet bazë të kompjuterit.
5. Kandidati duhet të ketë aftësi menaxhuese dhe aftësi për punë në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 18.02.2026 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.